



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj



№. 02-110/04-0029404/24
Data 27.06.2024

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR DRAFT-STATUTIN E QKMF-SË

Datë: 03.05.2024, ora 11:00

Vendi: Komuna Skenderaj / Salla e Kuvendit Komunal

Kryesuesi i mbledhjes: Kryesuesi i Komisionit, Besnik Smakaj

Në mbledhje morën pjesë: Anëtarët e komisionit, zyrtarë komunal, përfaqësues të OJQ-ve, qytetarë.

Procesmbajtës: Armend Musliu

Qëllimi i takimit: Konsultimi Publik për Draft-Statutin e QKMF-së në Skenderaj.

Takimin e hapi Drejtoresha e DSHMS-së Rrezarta Hasani-Ibrahimi, në ora 11:20.

Rrezarta Hasani-Ibrahimi: Përshendetje për të gjith komisioni ka punuar Draftin e Statutit të QKMF-së të cilet i falenderoj për punen dhe angazhimin e tyre. Fjalën e kaloi te Kryesuesi i Grupit.

Besnik Smakaj: Së pari ju përshëndes dhe ju uroj mirëseardhje.

E kemi thirrur sot këtë takim për diskutim publik rreth draft-statutit të QKMF-së në Skenderaj,

Hapi diskutimin me të pranishmit për pyetje dhe sygjerime.

Andaj, fjala është për ju.

Pyetje - Fatmir Osmani-Infermier në QKMF: Ne lidhje me nenin 2 të Draft të Statutit, i cili kërkoj që ky nen të largohet ku sipas tij është e pa nevojshme që në konkurs për Drejtor të jetë si kusht që kandidati të jetë Mjek Familjat për Drejtor të QKMF-së.

Besnik Smakaj- pajtohëm me ju që ky propozim të përfshihet në Draft.

Pyetje Es'heme Beka, merr shembull vendet tjera nëper institucionet tjera se si krijohen Menaxhmentet Shëndetësore ku përfshihen të gjitha profilet mjekësore, e njejtë kërkoj që ky propozim të futet në Draft Statutin e QKMF -së.

Besnik Smakaj: Nuk ka hapsirë ligjore për këtë ndryshim. Te gjitha ndryshimet që janë të arsyeshme dhe të lejuara me ligj do të përfshihen.

Ali Lutfiu: Unë mendoj se një çështje shumë me rëndësi janë edhe trajnimet e stafi, të cilat na duhen shumë. A mund të përfshihet edhe ato në këtë Draft-Statut?

Besnik Smakaj: Për aq sa na lejon ligji dhe sa parashihet në formën unike të Statutit, të gjitha rekomandimet e juaja do të përfshihen.

Besnik Smakaj: A ka dikush ndonjë koment tjetër rreth këtij drafti?

Nëse jo, ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe me kaq po e mbyllim këtë takim.

Kryesuesi mbylli takimin në ora: 12:00

Procesmbajtës: Armend Musliu

